


Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?

Prill 2021



Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?

Prill 2021

— Përmbajtja

- 3** Përmbledhje ekzekutive
- 4** Hyrje
- 5** Vlerësimi i Rregullores për Ballkanin Perëndimor
- 7** Ndikimi ekonomik i Covid-19 në Kosovë dhe Gjermani
- 11** Rregullorja e re për Ballkanin Perëndimor: Çfarë mund të presin kosovarët?
- 15** Përfundim

Përmbledhje ekzekutive

Në vitin 2015, Gjermania prezantoi Rregulloren për Ballkanin Perëndimor (RRBP) si mjet për krijimin e një rruge ligjore për imigracionin në Gjermani. Rregullorja targetonte migrantët potencialë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor pa ndonjë kërkesë zyrtare për kualifikim dhe ishte caktuar të skadonte në dhjetor të vitit 2020. Megjithatë, si rezultat i suksesit të rregullores, ajo u vazhdua deri në fund të vitit 2023, por me kusht që Zyra Federale e Punësimit e Gjermanisë (ZFP) të kufizonte numrin e aplikimeve të aprovuara paraprakisht përmes RRBP-së në 25,000 në vit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky studim kryesisht shërben për të matur ndikimin e shtrirjes së RRBP-së dhe rregullës së saj të re në Kosovë, ndërsa gjithashtu merr parasysh sfidat e paraqitura për ekonominë e Gjermanisë dhe Kosovës si dhe tregjet e punës si rezultat i pandemisë Covid-19 në vitin 2020.

Mes viteve 2016 dhe 2020, 320,489 aplikacione u dorëzuan në ZFP, e cila miratoi 259,725, nga të cilat 97,618 aplikantë morën viza për të punuar në Gjermani. Në mes të vitit 2020, Ministria Federale e Punës dhe e Çështjeve Sociale në Gjermani (BMAS) e konsideroi RRBP-në të suksesshme në atë se emigrantët treguan një shkallë të lartë të punësimit të qëndrueshëm dhe se në përgjithësi kishte papunësi të ulët. BMAS-i arriti në përfundimin se sukcesi i RRBP-së ka treguar se për një integrim efikas të fuqisë punëtore të huaj, mjafton që punëdhënësit të vendosin se kë do të punësojnë krahasuar me kufizimin e opsioneve të emigrantëve bazuar vetëm në kualifikimet e tyre të mëparshme.

Sidoqoftë, ndikimi i RRBP-së në të ardhmen është mjaft i pasigurt për dy arsye kryesore. Së pari, në vitin 2020, pandemia shkaktoi dallgë masive në ekonominë e Gjermanisë, gjë që gjithashtu u përkthye në ngurtësi sa i përket tregut të saj të punës në përgjithësi dhe pasiguri sa u përket mundësive për vende të punës. Në Gjermani, BPV-ja reale ra 11.3% mes tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020, papunësia kulmoi në 6.4% në gusht të vitit 2020 dhe norma e numrit të vendeve të lira të punës ra nga 3.3% në fund të vitit 2019 në 2.1% në fund të tremujorit të dytë të vitit 2020 për shkak të kërkesës më të ulët për punë. Së dyti, rregulla e re e RRBP-së për të vendosur tavan në miratimet e ZFP-së në 25,000 në vit për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2023 do të ulë drejtpërdrejt migrimin nga secili vend i targetuar. Në rastin e Kosovës, mund të presim rreth 7,500 para-aprovime nga Kosova çdo vit deri në vitin 2023, krahasuar me një mesatare prej 17,000 para vendosjes së këtij kufizimi. Për më tepër, nëse Ambasada e Gjermanisë në Kosovë mbetet e ngadaltë në përpunimin e aplikacioneve për viza si në vitet e mëparshme, mund të pritet që vetëm një të tretës së aplikantëve të aprovuar paraprakisht (2,000 sish, krahasuar me 5,000 sish para-kufizimit) me të vërtetë t'u jepen vizat.

Prandaj, për të vlerësuar më mirë ndikimin e Rregullores për Ballkanin Perëndimor në tregun e punës të Kosovës dhe në përgjithësi për ta bërë migracionin më efikas, ky studim rekomandon që Agjencia e Punësimit e Kosovës (APK) t'i vlerësojë dhe parashikojë siç duhet nevojat e tregut të punës në Kosovë duke mbledhur të dhëna mbi numrin e vendeve të lira të punës dhe kualifikimet profesionale dhe arsimore të të papunëve, përmes anketave periodike me bizneset ose shoqatat e biznesit në lidhje me nevojat aktuale dhe të parashikuara të punës. Për më tepër, Ministria e Financave, Punës dhe Trasnfereve (MFPT) në Kosovë duhet t'i përdorë të dhënat nga APK, për të hartuar politikat e migracionit të punës në përputhje me nevojat e tregut të punës. Për më tepër, kur të lidhin marrëveshje bilaterale të migracionit, MFPT-ja duhet t'i mbrojë të drejtat e migrantëve dhe të hartojë procedura të shpejta dhe të parashikueshme të migrimit. Në fund, Qeveria e Gjermanisë duhet të rrisë kapacitetin e ambasadës së saj në Prishtinë për të ulur kohën e procesimit të kërkesave për viza.

Hyrje

Për të kontrolluar fluksin në rritje të azilkërkuesve nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Gjermania futi në përdorim Rregulloren për Ballkanin Perëndimor (RRBP) në vitin 2015, e njohur edhe si neni 26.2 i “Urdhëresës së Punësimit”, duke krijuar një rrugë ligjore për punëtorët e këtij rajoni për të migruar në Gjermani. Kjo rregullore, e cila nuk kërkonte ndonjë shkathtësi të veçantë ose nivel të kualifikimit të punëtorëve, ishte përcaktuar të skadonte në dhjetor të vitit 2020.

Pas skadimit të RRBP-së, Këshilli Federal Gjerman (Bundesrat) vendosi ta vazhdojë rregulloren deri në fund të dhjetorit 2023, por ta kufizojë në 25,000 në vit, numrin e miratimeve që Agjencia Federale e Punësimit (AFP) mund të japë për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.¹ Kjo kuotë mund të përshtatet çdo vit bazuar në nevojat e tregut gjerman të punës dhe në kapacitetin e ambasadave të vendeve të origjinës për të procesuar vizat.² Nuk ka pasur asnjë ndryshim në procesin aktual të marrjes së miratimit të AFP-së. Ky tavan (kufizim) i ri prej 25,000 aprovimesh nga AFP-ja në vit, paraqet një rënie drastike të mundësive të emigracionit krahasuar me vitet e mëparshme, që mesatarisht ishte rreth 54,000.

Ashtu si RRBP-ja fillestare, para se të lëshohet ndonjë leje nga AFP-ja, kryhet një kontroll i prioritetit. Ky proces përfshin punëdhënësin gjerman që vërteton se asnjë punëtor vendas, i BE-së, ose të cilit i është njohur statusi i refugjatit, nuk mund ta plotësojë vendin e lirë të punës dhe se kushtet e punës nuk janë më pak të favorshme sesa ato të punonjësve vendorë. Për më tepër, aplikant nuk mund të jetë dikush që ka marrë përfitime përmes Aktit të Përfitimeve për Azilkërkues në 24 muajt para aplikimit në AFP.

Sidoqoftë, kufizimi i ri nuk do të ndikojë në “Aktin e Imigracionit të Kualifikuar” që zbatohet nga viti 2020 e që ka për pikësynim emigrantë me kualifikime të larta nga e gjithë bota, të cilët kanë përfunduar studime të larta ose trajnime në Gjermani ose që posedojnë ekuivalente të gradave ose të trajnimeve nga sistemi arsimor gjerman. Ky akt u propozua në një përpjekje për të reaguar ndaj mungesave të parashikuara të fuqisë punëtore me kualifikime të larta në Gjermani për vitet që po vijnë dhe është i ndarë nga Rregullorja për Ballkanin Perëndimor.³

Në shkurt të vitit 2020, Instituti GAP, në bashkëpunim me Këshillin e Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane për Integrim dhe Migrim (SVR), publikoi një raport të përbashkët me titull “Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani”.⁴ Ky raport përfshin tendencat e emigracionit nga Kosova në Gjermani në nivele kualifikimeve specifike sektoriale prej vitit 2016 deri në vitin 2020. Megjithatë, pandemia Covid-19 dhe skadimi i RRBP-së fillestare në vitin 2020 krijuan ndryshime të konsiderueshme si në tregun e punës, ashtu edhe në politikën e imigracionit. Këto ngjarje pritet të kenë ndikim të madh në fluksin e emigracionit të qytetarëve të Kosovës në Gjermani, duke bërë që hulumtimet shtesë mbi këtë temë të jenë qenësore.

Duke reflektuar mbi këto ndryshime të migracionit, në këtë studim prezantohen gjetje të reja në lidhje me vlerësimin e versionit të parë të RRBP-së dhe analizohet se si pandemia dhe kufiri i ri në aprovime, mund të ndikojnë në migrimin e punës në Gjermani.

1 Rregullorja për Ballkanin Perëndimor prej 1.1.2021. Agjencia Federale e Punësimit. Burimi: <https://bit.ly/2NQO8Ds> (deri sot është në dispozicion vetëm në gjermanisht)

2 Po aty,

3 Aktin e Imigracionit të Kualifikuar. Zyra e Jashtme Federale. Burimi: <https://bit.ly/3tyABiW>

4 “Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani – Vlerësim i shkurtër i kthimeve pozitive dhe negative”, Instituti GAP, Këshilli i Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane për Integrim dhe Migrim (SVR), shkurt 2020. Burimi: <https://bit.ly/3sM9sZY>

Vlerësimi i Rregullores për Ballkanin Perëndimor

Me fazën e parë të Rregullores për Ballkanin Perëndimor që përfundoi më 31 dhjetor 2020, kishte nevojë për një vlerësim gjithëpërfshirës të vetë rregullores dhe të efekteve të saj si mbi emigrantët, ashtu edhe mbi ekonomitë e vendeve partnere. Mes viteve 2016 dhe 2018, 65,171 individëve iu dhanë viza pune nga një numër marramendës prej 204,308 kontrata pune dhe si rrjedhojë edhe aplikime për viza të dorëzuara në Agjencinë Federale të Punësimit në Gjermani (AFP) nga individë nga i gjithë Ballkani Perëndimor. Gati një e treta e kontratave të punës u paraqiten vetëm nga qytetarët kosovarë (67,272 - më e larta nga Ballkani Perëndimor), nga të cilat rreth një të katërtës së tyre (15,734) iu dhanë viza pune.⁵ Një fluks i lartë imigrantësh për qëllime pune siç është ai nga RRBP-ja duhet të ketë efekt të konsiderueshëm në tregun e punës të Gjermanisë, ndërsa e njëjta rrjedhje e fuqisë punëtore nga vendet e Ballkanit Perëndimor mund të pritet të shkaktojë “ikjen e trurit” në disa prej industrive të tyre.

Në një raport hulumtimi të publikuar në prill të vitit 2020 nga Instituti për Kërkime të Punësimit (IAB) në emër të Ministrisë Federale të Punës dhe Çështjeve Sociale në Gjermani (BMAS), RRBP-ja u vlerësua të ketë qenë e suksesshme. Sipas gjetjeve kryesore të studimit, emigrantët kishin një normë të lartë të punësimit të qëndrueshëm dhe përgjithësisht kishte papunësi të ulët. Për më tepër, kur shikohen karakteristikat e ndryshme të emigrantëve, studimi konstatoi se 87% ishin burra dhe 74% ishin individë nën moshën 40 vjeç, gjë që përkon me rritjen e nevojës së Gjermanisë për të rinj në gjendje të mirë fizike, veçanërisht në industri të tilla si ndërtimtaria (ku 44% e atyre emigrantëve realisht gjetën punë).⁶ Ndër të tjera, gati 60% e emigrantëve u klasifikuan si ekspertë në fushat e tyre, ata me përvojë disa vjeçare – kualifikim ky që në disa raste për punëdhënësit ishte më i rëndësishëm sesa formimi i tyre arsimor.⁷

Studimi vjen në përfundim se suksesi i RRBP-së tregon se për integrim efikas të fuqisë punëtore të huaj është e mjaftueshme që punëdhënësit të vendosin kë të punësojnë krahasuar me kufizimin e opsioneve të emigrantëve duke u bazuar vetëm në kualifikimet e tyre. Në fund, ka prova se edhe efikasiteti dhe përgatitja e ambasadave dhe zyrave përkatëse administrative që merren me aplikimet kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në suksesin e RRBP-së.⁸ Sipas studimit, duket se RRBP-ja ka përmbushur objektivin e një “fitore të trefishtë”, ku vendi pritës, vendi i origjinës, dhe vetë emigrantët kanë përfituar nga kjo rregull.

Kur shikojmë imigrantët kosovarë që kanë emigruar përmes RRBP-së, studimi i vitit 2020 i publikuar nga GAP dhe SVR tregon se mes janarit 2016 dhe dhjetorit 2018, kishte 67,902 aplikime nga kosovarët të gatshëm për të migruar në Gjermani. Megjithatë, një e pesta e tyre u refuzua paraprakisht nga AFP (13,344), ndërsa 53,928 aplikacione u aprovuan paraprakisht dhe po prisnin t’u jepeshin vizat e pune nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë. Nga të gjithë aplikantët të cilëve u ishte dhënë aprovimi paraprak, 52% ishin në industrinë e ndërtimit, 15% në industrinë e ushqimit dhe akomodimit dhe 15% në industrinë e shërbimit administrativ, së bashku përbënin më shumë se 80% të para-aprovimeve.⁹ Studimi vjen në përfundim se për dallim nga Gjermania, Kosova nuk ka një renditje të industrive sipas rrezikut të ikjes së trurit, dhe për këtë arsye mund të mos jetë në gjendje ta vlerësojë saktë ndikimin e RRBP-së në tregun e saj të punës. Koncepti i “fitores së trefishtë” domosdoshmërisht mund të mos vlejë për industri të caktuara në Kosovë, veçanërisht në ato ku papunësia

5 Po aty, f. 15

6 “Evaluierung der Westbalkanregelung: Registerdatenanalyse und Betriebsfallstudien,” Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale në Gjermani, prill 2020, f. 15. Burimi: <https://bit.ly/3bpmtS1>

7 Po aty, f. 16

8 Po aty, f. 18-19

9 “Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani,” Instituti GAP, SVR, f. 24. Burimi: <https://bit.ly/3dAuHsS>

është e ulët dhe numri i aplikantëve të interesuar për vizat gjermane të punës është i lartë. Në këto industri hyjnë administrata dhe shërbimet mbështetëse, minierat dhe xehoret, pasuritë e paluajtshme, ndërtimtaria dhe shëndeti njerëzor.¹⁰

Studimi i publikuar në janar të vitit 2021 nga Qendra Gjermane për Informacion mbi Migracionin, Edukimin dhe Karrierën në Kosovë (DIMAK) ka analizuar pesë sektorë në Kosovë (TIK-un, gastronominë, inxhinierinë, kujdesin shëndetësor dhe bujqësinë), bazuar në anketat e punëdhënësve dhe punëmarrësve për vlerësimin e potencialit, rrezikut të ikjes së trurit dhe tendencës së punëmarrësve për të migruar.¹¹ Bazuar në atë studim, sektori i gastronomisë vuan nga një përqindje veçanërisht e lartë e ikjes, sepse shumica e vendeve të punës atje shihen si të përkohshme, ose vetëm si trampolinë për një karrierë tjetër. Si rezultat i ikjes së lartë, punëdhënësit hezitojnë të ofrojnë trajnimet shumë të nevojshme, gjë që vetëm e zgjat kohën kur punonjësit lihen zyrtarisht të pakualifikuar. Sidoqoftë, qarkullimi i lartë gjithashtu lë të kuptohet se rreziku i ikjes së trurit është relativisht i ulët për momentin, edhe pse punëdhënësit kanë frikë se nëse bizneset e reja vazhdojnë të hapen, furnizimi me fuqi punëtore do të bëhet i kufizuar.¹² Bazuar në rezultatet e anketës, rreth 47% e të punësuarve nga ai sektor raportuan pakënaqësi me jetën e tyre në Kosovë, dhe rreth një e treta e tyre raportuan se do ta kishin në konsideratë shpërnguljen jashtë vendit (me 56% që e zgjidhnin Gjermaninë) në dy vitet e ardhshme, kryesisht si rezultat i pagave të ulëta, kushteve të këqija të jetesës dhe mungesës së mundësive në Kosovë.¹³

Në sektorin e bujqësisë, punëdhënësit raportuan se mungesa e programeve financiare të qeverisë ose mbështetjes së shtetit në përgjithësi i ka lënë pagat relativisht të ulëta, duke rezultuar në mungesë të stimujve për punësim në këtë sektor. Ngjashëm me sektorin e gastronomisë, punonjësit potencialë në bujqësi janë kryesisht me kualifikime të ulëta dhe vetëm të përkohshëm. Llogaritja e rrezikut të ikjes së trurit për këtë sektor është mjaft e vështirë sepse gjersa punëdhënësit bien dakord që do të ketë një kërkesë të shtuar për fuqi punëtore me kualifikime të larta në të ardhmen, sektori mund të mos jetë në gjendje ta përmbushë kërkesën për shkak të mungesës së fondeve për pagat. Prandaj, gjersa është e mundur të pritet ikja e trurit si rezultat i migrimit të mundshëm të fuqisë punëtore, edhe nëse ata punëtorë do të qëndronin në Kosovë, ata mund të mos përdoren domosdoshmërisht.¹⁴ Megjithatë, ndonëse rezultatet e anketës tregojnë se rreth 40% e pjesëmarrësve ishin të pakënaqur me jetën e tyre në Kosovë, 39% nuk mendojnë të shpërngulen jashtë vendit në dy vitet e ardhshme.¹⁵ Kështu që është e mundur të supozohet se rreziku i ikjes së trurit në sektorin e bujqësisë ka të ngjarë të jetë marginal, veçanërisht kur merret parasysh se RRBP-ja ka si synim fuqinë punëtore me kualifikime të ulëta.

Është e qartë se një numër studimesh të mëparshme kanë vlerësuar ndikimin e RRBP-së në Gjermani dhe efektet e mundshme të ardhshme në Kosovë. Pavarësisht kësaj, ndryshimet e papara si rezultat i pandemisë dhe vendimi i Gjermanisë për të ndryshuar elementin kryesor të RRBP-së kërkojnë analiza të mëtejshme. Prandaj, ky studim i shoqëron raportet e mëparshme duke analizuar ndikimin e mundshëm të RRBP-së së vazhduar me kuotën e vetëm 25,000 aprovimeve të aplikacioneve në vit. Ky kufizim ka të ngjarë të shtypë fluksin e migrantëve të pakualifikuar dhe mund të mos jetë aq i suksesshëm sa paraardhësi i tij.

¹⁰ Po aty, f. 27

¹¹ "Hulumtim mbi tregun e punës/migracionin – Raport i gjetjeve, "Qendra Gjermane për Informacion mbi Migracionin, Edukimin dhe Karrierën (DIMAK), janar 2021

¹² Po aty, f. 25-27

¹³ Po aty, f. 26, 36-27

¹⁴ Po aty, f. 65-66


¹⁵ Po aty, f. 67, 75-76

Ndikimi ekonomik i Covid-19 në Kosovë dhe Gjermani

Si rezultat i mbylljeve të imponuara nga qeveritë në Gjermani dhe Kosovë, ekonomitë e të dyja vendeve përjetuan luhajtje të mëdha në të ardhura dhe veçanërisht në tregun e punës gjatë vitit 2020. BPV-ja e të dyja vendeve përjetoi rënie në tremujorin e dytë të vitit 2020, me rënieën e Gjermanisë të krahasueshme me atë të shkaktuar nga kriza financiare e vitit 2008. Në fakt, bazuar në të dhënat e Zyrës Federale të Statistikave të Gjermanisë (Destasis), BPV-ja reale ra nga 105 miliardë Euro në tremujorin e parë të vitit 2020 në 94.7 miliardë Euro në tremujorin e dytë (-11.3 %). Në tremujorin e tretë të vitit 2020 u vërejt një ngritje prej 8.5% në 102.7 miliardë Euro, por ishte akoma më e ulët se tremujori i tretë i vitit 2019 (107 miliardë Euro) për 4%.¹⁶ Po kështu, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2020 (1.7 miliardë Euro) ishte 9.3% më e ulët se në vitin 2019 (1.8 miliardë Euro). BPV-ja reale në tremujorin e tretë të vitit 2020 (1.8 miliardë Euro) ishte 7.3% më e ulët se në vitin 2019 (2 miliardë Euro).¹⁷

Përveç që kjo ndikoi në të ardhurat, mbylljet ndikuan edhe në tregjet e punës. Meqenëse mbylljet ekonomike u shfrytëzuan për të parandaluar përhapjen e Covid-19, sektorë të tërë ekonomike në Kosovë dhe Gjermani u mbyllën ose operuan me një kapacitet të kufizuar. Si rezultat, një numër i konsiderueshëm i individëve papritur u gjendën të papunë. Nëse vëzhgohet tregu i punës në Gjermani, bëhet e qartë se papunësia u rrit ndjeshëm gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë të vitit 2020. Mes janarit dhe gushtit të vitit 2020, papunësia u rrit me 1.1 pikë përqindjeje, duke kulmuar në 6.4% në gusht të vitit 2020. Nga fundi i tremujorit të tretë, shkalla e papunësisë ra ngadalë dhe u zbrit në 5.9% në dhjetor të vitit 2020.¹⁸

Figura 1. Norma mujore e papunësisë në Gjermani (%)



Burimi: Zyra Federale e Statistikave e Gjermanisë (Destasis)

Punësimi në Gjermani nuk ndryshoi aq shumë sa shkalla e papunësisë. Gjersa ajo

¹⁶ "Bruto Prodhimi Vendor (PBB)/rritja ekonomike," Zyra Federale e Statistikave (Destasis), 2021.


Burimi: <https://bit.ly/3iYcExx>

¹⁷ "Bruto Prodhimi Vendor sipas shpenzimeve dhe qasjes ndaj prodhimit, Q3 2020," Agjencia e Statistikave e Kosovës, 2020. Burimi: <https://bit.ly/3sYFFhn>

¹⁸ Papunësia si përqindje e fuqisë punëtore civile, Destasis. Burimi: <https://bit.ly/3k6YDym>

ra në tremujorin e dytë të vitit 2020 me 1.4% krahasuar me tremujorin e parë, ajo shpejt u kthye gati në gjendjen e saj fillestare në tremujorin e tretë. Kur krahasohet me tremujorin e dytë të vitit 2019, punësimi në tremujorin e dytë të vitit 2020 ishte më i ulët për vetëm 1.5%.¹⁹

Figura 2. Ndryshimi në përqindje i punësimit për tremujor në Gjermani



Burimi: Zyra Federale e Statistikave e Gjermanisë (Destasis)

Punësimi stabil i Gjermanisë është kryesisht rezultat i programit “punë me kohë të shkurtuar” që përdoret nga qeveria gjermane. Ky program u mundëson punëdhënësve të zvogëlojnë orarin e punës së të punësuarve, pa pasur nevojë për pushime nga puna, pasi qeveria e kompenzon ndryshimin sa u përket të ardhurave.²⁰ Numri i punëtorëve me kohë të shkurtuar kulmoi në prill të vitit 2020 në gati gjashtë milion dhe ra vetëm pak në maj të vitit 2020 në 5.9 milion.²¹ Gjersa programi i punës me kohë të shkurtuar zbuti disa nga ndikimet e krizës ekonomike të shkaktuara nga pandemia, sektorë të caktuar ekonomikë ende përjetuan rënie të mëdha në punësim. Kur e krahasohet dhjetori i vitit 2020 me të njëjtin muaj të vitit 2019, punësimi në aktivitetet e shërbimit administrativ dhe mbështetës u ul me 16.2%, industria e akomodimit dhe e shërbimit ushqimor me 7.5% dhe industria e metaleve dhe e energjisë elektrike me 2.6%. Nga ana tjetër, sektorë të tillë si furnizimi me ujë dhe energji elektrike u rritën me 4.7%, industria e informacionit dhe e komunikimit me 2.8% dhe sektori i kujdesit shëndetësor me 2.1%.²²

Rënia e të ardhurave reflektohet gjithashtu në një kërkesë më të ulët për punëtorë të rinj, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, kur norma e numrit të vendeve të lira të punës ra me 1.2 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin paraardhës.²³ Numri më i ulët i vendeve të lira të punës mund t’i atribuohet pasigurisë në lidhje me ndryshimet në numrin e vendeve të punës, gjë që rezultoi në më pak nevojë për hapje të vendeve të reja të punës, pasi individët nuk janë të interesuar të ndërrojnë punë gjatë periudhës së paqëndrueshmërisë.²⁴

¹⁹ Të punësuarit në varësi të kontributeve të sigurimit social në vendin e tyre të punës, Destasis.

Burimi: <https://bit.ly/3qCt4yz>

²⁰ “Monitorimi i reagimit ndaj krizës COVID-19,” Instituti për Studime të Punës (IZA), dhjetor 2020.

Burimi: <https://bit.ly/2ZugUMe>

²¹ Po aty, f. 6


²² “Monatsbericht zum Arbeits- und Ausbildungsmarkt,” Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë, janar 2021, faqe 48. Burimi: <https://bit.ly/2NlWYJ9>

²³ Eurostat. Statistikat mbi konkurset për vendet e punës nga NACE Rev. 2 aktiviteti – të dhënat për tremujorin.

Burimi: <https://bit.ly/2LJND0z>


²⁴ “Monatsbericht zum Arbeits- und Ausbildungsmarkt,” Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë, janar 2021, f.

14-15. Burimi: <https://bit.ly/2NlWYJ9>

Figura 3. Norma e numrit të vendeve të lira të punës për tremujor në Gjermani

Burimi: Eurostat

Ndonëse numri i vendeve të lira të punës në total u ul me afërsisht një të tretën mes viteve 2019 dhe 2020, struktura e vendeve të lira të punës sipas industrisë mbetet kryesisht e njëjtë. Tregu gjerman i punës ende përballet me nevojën për të plotësuar vendet e lira në sektorin e kujdesit shëndetësor, shërbimet administrative dhe mbështetëse dhe ndërtimtari.²⁵ Megjithatë, zvogëlimi i nevojës për punë në vitin 2020 në kuadër të disa industrive të tilla si ndërtimi, ku një numër i madh i aplikantëve kosovarë përmes RRBP-së kanë shprehur interes për të punuar gjatë dy viteve të fundit, nuk ka përcaktuar ose ndryshuar domosdoshmërisht nevojat e tregut gjerman të punës për vitet që vijnë që nga efektet e pandemisë, ndonëse të dëmshme, ato efekte pritet të treten në fund.


Figura 4. Mesatarja e numrit të vendeve të lira të punës sipas industrisë në Gjermani

Burimi: Eurostat

25 Eurostat. Statistikat mbi konkurset për vendet e punës nga NACE Rev. 2 aktiviteti – të dhënat për tremujorin.
Burimi: <https://bit.ly/2UJND07>

Ngjashëm me Gjermaninë, Kosova ka përjetuar një rritje të konsiderueshme prej dy pikë përqindjeje në shkallën e saj të papunësisë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, duke kulmuar në 27%, e cila më pas u stabilizua në 25% në tremujorin e tretë, e ngjashme me nivelet e para-mbylljes. Punësimi pësoi një rënie të madhe nga tremujori i parë i vitit 2020 në tremujorin e dytë, kur numri i individëve të punësuar ra prej rreth 354,700 në 294,600. Sidoqoftë, gjatë tremujorit të tretë, numri i individëve të punësuar u kthye në pak më i lartë se gjendja e mëparshme, një rritje prej 25%, me 368,100 të punësuar.²⁶ Ngjashëm me Gjermaninë, një rënie afatgjatë e punësimit mund të jetë shmangur si rezultat i paketës emergjente fiskale nga Qeveria e Kosovës, që, midis disa masave të menjëhershme financiare, premtoi mbështetje në vlerë prej gjashtë milion Euro për kompanitë që regjistruan punonjës të rinj gjatë pandemisë me kontrata pune të paktën një vit. Deri në qershor të vitit 2020, gati 15 mijë punëtorë aplikuan për atë mbështetje.²⁷ Ndonëse masat financiare emergjente lehtësuan disa nga humbjet në punësim, sektorë të caktuar ekonomikë prapëseprapë pësuan humbje të mëdha. Kur krahasohet tremujori i tretë i vitit 2020 me të njëjtin tremujor të vitit 2019, punësimi në prodhim kishte rënë me 6.1%, tregtia me shumicë dhe pakicë me 3.7% dhe bujqësia me 3.3%. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, disa sektorë përjetuan rritje të punësimit si rritja prej 2.3% në furnizimin me ujë dhe energji elektrike, 2.1% në kujdesin shëndetësor dhe 1.8% në miniera.²⁸ Për të siguruar që të kemi një pasqyrë të qartë të ndikimit të pandemisë në tregun e punës dhe çfarë do të thotë kjo për migracionin, Agjencia e Punësimit e Kosovës rregullisht duhet t'i vlerësojë dhe parashikojë nevojat e tregut të punës në Kosovë, duke mbledhur të dhëna gjithëpërfshirëse për vendet e lira të punës (për të cilat Kosova nuk ka të dhëna të krahasueshme me Gjermaninë) dhe formimin profesional dhe arsimor të të papunëve përmes anketave periodike me bizneset ose shoqatat e biznesit në lidhje me nevojat aktuale dhe të parashikuara të punës.

Figura 5. Shkalla e papunësisë për tremujor (%) dhe përqindja e ndryshimit të punësimit në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

²⁶ Punësimi në tremujor sipas aktivitetit dhe gjinisë, dhe numri i të papunëve dhe niveli i papunësisë për tremujor, sipas gjinisë. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3s3oPfk>

²⁷ "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës," Instituti GAP, qershor 2020, f. 16. Burimi: <https://bit.ly/3rKdyAv>

²⁸ Punësimi për tremujorin sipas aktivitetit dhe gjinisë. Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Burimi: <https://bit.ly/3s3oPfk>

Duke parë që situata aktuale e pandemisë ka shkaktuar dallgë në të dyja tregjet e punës në Gjermani dhe Kosovë, është e natyrshme të supozohet se edhe emigracioni për qëllime të punës ka qenë i ndikuar. Si rezultat i uljes së punësimit në sektorë të caktuar gjermanë, përparësitë e punësimit, veçanërisht për fuqinë punëtore të huaj, mund të jenë zhvendosur. Në të vërtetë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) duhet t'i marrë parasysh këto ndryshime në Gjermani kur harton politikat e migrimit të punës për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të migrantëve kosovarë dhe procedurat efikase të migrimit. Në pjesën tjetër, në këtë studim analizohen të dhëna të reja mbi fazën e parë të RRBPs-së, se si pandemia mund të ndikojë në imigrim dhe se çfarë do të thotë kufizimi i ri i RRBPs-së për aprovimet për migrimin e ardhshëm të kosovarëve në Gjermani.

Rregullorja e re për Ballkanin Perëndimor: Çfarë mund të presin kosovarët?

Mes viteve 2016 dhe 2019, numri i përgjithshëm i kontratave të punës, dhe, kësaj, numri i kërkesave të paraqitura në Agjencinë Federale të Punësimit të Gjermanisë (AFP) për shqyrtim u rrit. Numri i aplikacioneve kosovare (gjithsej 83,570 deri në fund të vitit 2019) u luhet, por përgjithësisht përbënte 30% të të gjitha aplikacioneve nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, aplikacionet kosovare përbënin 30% të para-aprovimeve (67,730) dhe 30% të para-refuzimeve (15,840); raporti i para-aprovimeve ndaj para-refuzimeve të aplikacioneve kosovare ishte katër me një. Përkundër numrit të lartë të aplikacioneve të paraqitura prej vitit 2016 deri në 2019, në vitin 2020 u vërejt një rënie të madhe e numrit të aplikacioneve të paraqitura. Si rezultat i kufizimeve të udhëtimit dhe pasigurive në tregun e punës, numri i përgjithshëm i aplikacioneve sipas RRBPs-së ra prej 75,032 në vitin 2019 në 40,819 në 2020. Numri i aplikimeve nga Kosova po ashtu ra prej 16,298 në vitin 2019 në 9,085 në vitin 2020, dhe përbënin vetëm 22% të të gjitha aplikacioneve.







Ndër të tjera, para-aprovimi nuk garanton se dikush do të marrë vizë, kryesisht për shkak të gabimeve në aplikim dhe kapaciteteve të përpunimit të ambasadave. Si e tillë, mes viteve 2016 dhe 2019, vetëm 35% deri 45% e aplikantëve të para-aprovar nga AFP-ja morën viza. Në fakt, në vitin 2020, norma e vizave të lëshuara si pjesë e para-aprovimeve të dhëna ra në 14% mesatarisht (duke mos njehur Malin e Zi që pati normë të jashtëzakonshme prej 43%). Ambasada në Prishtinë lëshoi 834 viza në kuadër të RRBPs, të cilat përbënin 11% të para-aprovimeve të dhëna në 2020 për Kosovë. Kjo erdhi kryesisht si rezultat i faktit që Ambasada Gjermane në Prishtinë njoftoi në Mars që nuk do të procesonte më aplikime për viza.²⁹ Në kohën kur po shkruhet ky studim, vizat afatshkurtra mbeten të kufizuara vetëm në raste të rralla dhe, çka është më e rëndësishmja, aplikimet sipas RRBPs-së nuk pranohen aspak nga Ambasada në Prishtinë, pjesërisht për shkak të kufizimit të ri të RRBPs-së dhe pjesërisht për shkak të kufizimeve të udhëtimit.³⁰ Megjithatë, kjo nuk e zvogëlon gjendjen fatkeqe që ambasada në Prishtinë është me staf të paktë dhe të pa pajisur si duhet për të trajtuar sasinë masive të aplikimeve. Në fakt, prej vitit 2017 deri në vitin 2020, vetëm gjashtë anëtarë shtesë të stafit i janë bashkuar ambasadës, gjersa numri i aplikacioneve po rritet vazhdimisht.³¹

29 Njoftim i Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë. Burimi: <https://bit.ly/2M5WBBX>

30 Informacion mbi vizat. Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë. Burimi: <https://bit.ly/3boEMqn>; Rregullorja e re për punë për aplikantët nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë. Burimi: <https://bit.ly/37s82v4>

31 "Vizat e punës nga Ballkani Perëndimor 2019," Bundestagu Gjerman. Burimi: <https://bit.ly/2OSYx1H>

Tabela 1. Numri i para-aprovimeve, para-refuzimeve dhe i vizave të lëshuara sipas nenit 26.2

								
	Viti	Totali	SHQ	BeH	RKS	MKD	MZ	SRB
Kontrata pune dorëzuar në Agjencinë e Punësimit për rishikim sipas §26.2	2016	53,583	3,933	13,889	18,182	6,213	1,313	10,050
	2017	94,280	8,235	21,206	36,245	11,452	1,839	15,301
	2018	56,775	9,376	11,398	12,845	12,683	1,978	8,495
	2019	75,032	12,397	17,466	16,298	15,696	2,886	10,287
	2020	40,819	7,072	8,782	9,085	9,142	1,659	5,077
Para-aprovim është miratuar	2016	42,546	2,977	11,330	14,419	4,746	1,012	8,059
	2017	74,577	6,053	17,220	28,816	8,918	1,433	12,135
	2018	46,118	7,052	9,684	10,693	10,059	1,476	7,154
	2019	62,334	9,665	14,862	13,802	13,062	2,347	8,595
	2020	34,150	5,658	7,588	7,634	7,646	1,376	4,248
Para-aprovim është refuzuar	2016	11,037	956	2,559	3,763	1,467	301	1,991
	2017	19,703	2,182	3,986	7,429	2,534	406	3,166
	2018	10,657	2,324	1,714	2,152	2,624	502	1,341
	2019	12,698	2,732	2,604	2,496	2,634	539	1,692
	2020	6,669	1,414	1,194	1,451	1,496	283	829
Vizat janë lëshuar sipas §26.2	2016	18,752	1,228	5,581	5,102	2,635	678	3,528
	2017	25,341	2,796	5,933	6,012	5,167	856	4,577
	2018	21,078	4,254	2,612	4,710	5,360	971	3,171
	2019	27,259	4,059	7,223	4,777	6,425	1,596	3,179
	2020	5,188	893	1,047	834	1,291	596	527

Burimi: Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë, Bundestagu Gjerman³², Grupi i Strategjisë së Migracionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar³³

32 “Vizat e punës nga Ballkani Perëndimor 2019,” Bundestagu Gjerman. Burimi: <https://bit.ly/2OSYx1H>;

“Vizat e punës nga Ballkani Perëndimor 2020,” Bundestagu Gjerman. Burimi: <https://bit.ly/2PLxjux>

33 “Krijimi i rrugëve ligjore për të zvogëluar migracionin e parregullt. Çfarë mund të mësojmë nga ‘Rregullorja për Ballkanin Perëndimor’ e Gjermanisë,” Grupi i Strategjisë së Migracionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, 2018, f. 19. Burimi: <https://bit.ly/3qEEsu6>

Ngjashëm me periudhën 2016–2018 të studiuar nga GAP dhe SVR në studimin e vitit 2020,³⁴ pjesa më e madhe e para-aprovimeve të dhëna nga AFP për aplikantët kosovarë ishin në industrinë e ndërtimitarisë (rreth 50% në të dy vitet 2019 dhe 2020), aktivitetet e akomodimit dhe të shërbimit ushqimor (15% mesatarisht për çdo vit), dhe veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe mbështetës (15% mesatarisht për çdo vit). Të njëjtat profesione po ashtu e kishin numrin më të lartë të aplikacioneve të refuzuara.

Tabela 2. Numri i para-aprovimeve të miratuara dhe të refuzuara sipas nenit 26.2 për aplikantët kosovarë, sipas industrisë

	2019		2020		Totali	
	Miratuara	Refuzuara	Miratuara	Refuzuara	Miratuara	Refuzuara
Gjithsej	13774	2473	7578	1405	21352	3878
A Bujqësi, pylltari dhe peshkim	132	10	61	8	193	18
B Miniera dhe xehrore	24		7	*	31	*
C Prodhimi	942	150	462	62	1404	212
D Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	7	*	*	*	7	*
E Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	43	5	21	8	64	13
F Ndërtimtari	6732	1232	3808	668	10540	1900
G Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe i motoçikletash	619	158	359	86	978	244
H Transporti dhe depozitim	539	77	301	71	840	148
I Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimesh ushqimi	2172	328	1003	231	3175	559
J Informim dhe komunikim	35	6	9	*	44	6
K Aktivitetet financiare dhe sigurimesh	3	6		*	3	6
L Aktivitete me prona të paluajtshme	30	9	19	11	49	20
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	109	28	88	15	197	43
N Aktivitetet administrative dhe shërbime mbështetëse	1973	405	1212	217	3185	622
O Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	9	*	3	*	12	*
P Arsimit	6	*	*	*	6	*
Q Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	196	27	156	28	352	55
R Arti, zbavitja dhe rekreacioni	21	5	5	*	26	5
S Aktivitete të shërbimeve të tjera	165	23	56	*	221	23
T Aktivitetet të punësimit shtëpiak	17	4	8	*	25	4
U Aktivitetet e institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	*	*	*	*	*	*

Burimi: Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë

34 “Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani,” Instituti GAP, SVR. Burimi: <https://bit.ly/3sM9sZY>

Sidoqoftë, me gjithë rritjen e papunësisë në Gjermani në vitin 2020, ulja e normave të numrit të vendeve të lira të punës në disa industri, si dhe kufizimet e udhëtimit që nuk u lejonte aplikantëve të RRBP-së të pajiseshin me viza, kërkesa për punëtorë nga vendet e Ballkanit Perëndimor gjithsesi nuk do të ulj përgjithmonë (përveç për fazën e dytë kufizimi i RRBP-së që të pranojë vetëm 25,000 aplikime çdo vit). Me përjashtim të sektorit gjerman të gastronomisë që përjetoj një mbyllje më të ashpër dhe faktit se mundësitë e reja të punësimit mbeten të tendosura krahasuar me nivelet para-Covid-19, ekonomia gjermane duket se është akoma në gjendje të pranojë aplikantë sipas RRBP-së, e vërtetuar kjo nga normat e larta të para-aprovimit edhe në vitin 2020 (mbi 80% të kërkesave totale). Për më tepër, ndonëse rikuperimi pas Covid-19 mund të jetë i ngadaltë dhe gradual, barra aktuale në tregun e punës është vetëm e përkohshme dhe gjendja e biznesit si zakonisht mund të pritët për vitet në vijim.

Sidoqoftë, me gjithë presionin në tregun gjerman të punës gjatë vitit 2020, Rregullorja për Ballkanin Perëndimor u konsiderua e suksesshme në fund të fazës së saj të parë.³⁵ U bë e qartë se mjafton që punëdhënësit gjermanë të lejohen të vendosin se kë ta punësojnë, në vend se t'u kufizohen mundësitë e punësimit të emigrantëve bazuar vetëm në kualifikimet e tyre. Për më tepër, nëse ambasadat në vendet e Ballkanit Perëndimor janë efikase dhe të përgatitura për t'u marrë me aplikimet, atëherë duhet të sigurohet një proces i papenguar. Sidoqoftë, kjo mund të konsiderohet si pikë negative për Kosovën, ku Ambasada e Gjermanisë është dëshmuar të jetë e ngadalshme dhe joefikase, kryesisht për shkak të numrit joadekuat të personelit për procesimin e numrit të lartë të kërkesave të përgjithshme për viza.³⁶ Sipas studimit të GAP-it dhe SVR-së të vitit 2020, periudha e pritjes për aplikimet për viza përmes Rregullores për Ballkanin Perëndimor në Kosovë pritët të jetë më shumë se një vit, dhe shumë punëdhënës nuk mund të presin aq gjatë për të plotësuar një pozitë të hapur.³⁷

Përveç çështjes së mosdhënies së vizave në mënyrë efikase, kosovarët e interesuar për të migruar në Gjermani përmes RRBP-së tani do të përballen me rregulla më të rrepta për shkak të kufizimit të vetëm 25,000 aprovimeve për punë në vit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor së bashku deri në fund të vitit 2023. Nëse supozojmë që pjesa e para-aprovimeve nga Kosova do të mbetet e njëjtë si në vitet e mëparshme (rreth 30%), mund të presim rreth 7,500 para-aprovime të vijnë nga Kosova çdo vit deri në vitin 2023. Sidoqoftë, mund të pritët që vetëm një e treta e këtyre para-aprovimeve (2,000) të pajisen me viza (bazuar në normën mesatare të mëparshme të lëshimit të vizave për RRBP-në) nëse Ambasada e Gjermanisë në Kosovë nuk bën asgjë për të rritur efikasitetin e saj. Duke marrë parasysh se mesatarisht rreth 17,000 kosovarë para-aprovoheshin çdo vit mes viteve 2016 dhe 2019, 7,500 para-aprovime të mundshme në vit për 2021-2023 është një zvogëlim i konsiderueshëm dhe ka të ngjarë të ketë shumë më pak ndikim në tregun gjerman ose kosovar të punës.

Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për Aktin e Imigracionit të Kualifikuar, ambasadat gjermane në të gjithë botën kanë arritur të japin 30,200 viza prej 1 marsit deri më 31 dhjetor të vitit 2020. Megjithëse Akti i Emigracionit të Kualifikuar jo domosdoshmërisht i targeton vendet e Ballkanit Perëndimor, katër nga ato vende - Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Shqipëria - kanë arritur të kryesojnë listën e vendeve me lëshimet më të larta të vizave sipas këtij akti. Sipas Zyrës së Jashtme Federale Gjermane, Ambasada e Gjermanisë në Beograd lëshoi 2,024 viza, në Sarajevë 1,159

35 "Evaluierung der Westbalkanregelung," Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale në Gjermani.

Burimi: <https://bit.ly/3bpmt51>

36 Përgjigjet në pyetjet e parashtruara në Bundestagun Gjerman. Bundestagu Gjerman. prill 2020, f. 5

Burimi: <https://bit.ly/3bdYBjS>

37 "Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani," Instituti GAP, SVR, f. 16. Burimi: <https://bit.ly/3sMgsZY>

viza, në Prishtinë 792 dhe në Tiranë 778.³⁸ Duke marrë parasysh se mungesa e fuqisë punëtore me kualifikim të ulët eventualisht mund të jetë problematike për vendet e Ballkanit Perëndimor, dalja e shtuar e fuqisë punëtore me kualifikime të larta mund të jetë e dëmshme për këto vendet. Në rastin e Kosovës, ikja e trurit në sektorët e TIK-ut, inxhinierisë dhe kujdesit shëndetësor është veçanërisht kërcënuese për tregun e saj të punës sipas punëdhënësve nga ata sektorë.³⁹ Në fakt, në një studim të fundit, Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare raporton se mes periudhës 2016-2018 Kosova u përball me një normë mesatare të emigracionit neto prej 7% (e dyta më e larta mes vendeve të Ballkanit Perëndimor), ku në emigrimin e fuqisë punëtore me kualifikim të lartë prijnë në mënyrë të konsiderueshme të diplomuarit nga universitetet kohëve të fundit.⁴⁰

Përfundim

Rregullorja për Ballkanin Perëndimor, e prezantuar në vitin 2015 për t'u dhënë punëtorëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor të të gjitha niveleve të kualifikimeve qasje më të lehtë në tregun gjerman të punës, përfundoi fazën e saj të parë në dhjetor të vitit 2020. Arsyetimi kryesor prapa kësaj rregulle ishte krijimi i rrugëve ligjore për migracionin, dhe në të njëjtën kohë u identifikuan po ashtu disa nga përfitimet e saj në adresimin e nevojave të tregut gjerman të punës. Në të vërtetë, gjatë pesë viteve të fundit, RRBP-ja ka tërhequr më shumë se 300,000 aplikime nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Një raport i bërë nga Instituti për Hulumtime të Punësimit në emër të Ministrisë Federale të Punës dhe të Çështjeve Sociale në Gjermani deklaroi se RRBP-ja ishte e suksesshme në përmbushjen e qëllimit të saj për tërheqjen e fuqisë punëtore për industrinë në Gjermani që luftojnë për të punësuar punëtorë vendorë. Sidoqoftë, gjersa RRBP-ja ishte paraparë të përfundonte në vitin 2020, disa institucione e kuptuan nevojën për ta vazhduar atë, për të vazhduar plotësimin e nevojave të tregut gjerman të punës dhe RRBP-ja u lejua të vazhdonte deri në vitin 2023 me kusht që të mos jepen më shumë se 25,000 aprovime për punë në vit nga Agjencia Federale Gjermane e Punësimit. Ky kufizim ka të ngjarë të shtyp migrimin e punës së pakualifikuar dhe pritet të shkaktojë një ndikim të kufizuar në ekonominë e Gjermanisë.

Në vitin 2020 u vërejtën gjithashtu ndryshime të mëdha në ekonominë e Kosovës dhe të Gjermanisë, dhe veçanërisht në tregjet e tyre të punës, si rezultat i pandemisë Covid-19. BPV-të e tremujorit të të dyja vendeve ranë me rreth 10% në mes të vitit 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Për më tepër, papunësia u rrit për shkak të masave të mbylljes në të dyja vendet. Punësimi mori një goditje të menjëhershme gjithashtu, ndonëse arriti të stabilizohej si rezultat i politikave emergjente të tregut të punës. Natyrisht, u prek edhe migrimi i punës përmes RRBP-së, ku në vitin 2020 u pa një rënie prej 46% të aplikacioneve të paraqitura në agjencinë gjermane të punësimit, numër ky që u prek nga një kombinim i presionit në tregun gjerman të punës, kufizimeve të udhëtimit dhe kapaciteteve të kufizuara të procesimit të ambasadave gjermane në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Nëse presioni i lidhur me pandeminë në tregun e punës do të ndikojë në migrim mbetet të shihet. Sidoqoftë, edhe në vitin 2020, migrimi nga sektorë të tillë si ndërtimi, administrata dhe shërbimet mbështetëse, akomodimi dhe shërbimet e ushqimit mbetet i lartë. Ndër të tjera, mund të pritet që tregjet e punës përfundimisht të stabilizohen dhe migrimi të përballlet me më pak kufizime.

38 "Punëtorët e kualifikuar nga Ballkani Perëndimor përfituan më së shumti nga Akti i Imigracionit të Kualifikuar të Gjermanisë në vitin 2020," SchengenVisaInfo, mars 2021. Burimi: <https://bit.ly/38SOcdj>

39 "Hulumtim mbi tregun e punës/migracionin," DIMAK, janar 2021, f. 14, 40, 52

40 Sandra M. Leitner, "Migrimi neto dhe përbërja e tij e shkathtësive në vendet e Ballkanit Perëndimor mes viteve 2010 dhe 2019: Rezultatet nga qasja e grupit," Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, mars 2021, f. 14. Burimi: <https://bit.ly/31nfWCN>

Gjetjet tona sugjerojnë se një faktor kryesor kufizues për migracionin do të jetë caktimi i kufirit të aprovimeve në 25,000 aplikimesh nga Qeveria e Gjermanisë. Ne presim që para-aprovimet nga Kosova të bien prej 17,000 (bazuar në mesataren për fazën e parë të RRBP-së), në 7,500. Duke qenë se jo të gjithë aplikantët do të marrin viza pune, priten vetëm 2,000 migrantë potencialë realë në vit. Kjo pritet të ketë ndikim shumë më të vogël në tregjet e punës të Gjermanisë dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, pavarësisht nga nevojat e vazhdueshme të tregut gjerman të punës për punëtorë të tillë.

Prandaj, për të vlerësuar më mirë ndikimin e Rregullores për Ballkanin Perëndimor në tregun e punës të Kosovës dhe për ta bërë migrimin në përgjithësi më efikas, Instituti GAP rekomandon që:

- Agjencia e Punësimit e Kosovës (APK) duhet t'i vlerësojë dhe parashikojë siç duhet nevojat e tregut të punës në Kosovë. Për ta bërë këtë, APK-ja duhet të mbledhë të dhëna gjithëpërfshirëse për vendet e lira të punës dhe formimin profesional dhe arsimor të të papunëve. Duhet të kryejë anketa të rregullta/periodike me bizneset ose shoqatat e biznesit në lidhje me nevojat aktuale dhe të parashikuara të punës. Bashkëpunimi me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, agjencitë lokale të punësimit, OJQ-të dhe odat e tregtisë është thelbësore për të siguruar rezultate të shpejta dhe me kosto efektive.
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në Kosovë duhet t'i përdorë të dhënat nga APK-ja për të hartuar politikat e migracionit të fuqisë punëtore në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ndër të tjera, gjatë lidhjes së marrëveshjeve bilaterale të migracionit, MFPT-ja duhet t'i mbrojë të drejtat e migrantëve, të ndajë koston e migracionit të punës (udhëtimet, kurset e gjuhës, etj.), dhe të hartojë procedura të shpejta dhe të parashikueshme të migracionit. Marrëveshjet për punë sezonale mund të shihen si një mundësi për profesionet ku Kosova ka shkallë të ulët të papunësisë.
- Qeveria e Gjermanisë duhet të rrisë kapacitetin e ambasadës së saj në Prishtinë. Prej vitit 2017 deri në vitin 2020, vetëm gjashtë anëtarë të stafit i janë bashkuar, ndërsa numri i aplikimeve është rritur me shpejtësi. Plotësimi me staf, si dhe metodologjitë e duhura (për përzgjedhjen dhe verifikimin e migrantëve) mund ta zvogëlojnë kohën e procesimit që aktualisht është e paqëndrueshme. Më tej, duhet të hulumtohet nëse dhe deri në çfarë shkalle Zyra Federale e Punëve të Jashtme në Berlin mund të lehtësojë barrën mbi përfaqësitë e jashtme të mbingarkuara gjermane në rajon, duke marrë përsipër shërbimet e vizave.⁴¹

41 Zyra Federale për të Huajtë. Projektligji parashikon që Zyrës Federale për Punë të Jashtme të mund t'i caktohen detyra të Shërbimit të Jashtëm në procedurën e vizave. Burimi: <https://bit.ly/zUPxxBh>


Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga:



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**

Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe
kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në
migrimin nga Kosova?

